



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.01.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64, datë 31.05.2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar”. *(komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Arben Pëllumbi, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Edmond Panariti.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Roland Kristo – Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Arian Palluqi – Përgjegjës Sektori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në Fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi - Mirëmëngjesi!

Meqenëse plotësohet kuorumi fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin. Sot në rendin e ditës kemi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64, datë 31.05.2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar”. Relatore është zonja Eglantina Gjermani.

Të ftuar kemi zotin Roland Kristo, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe zotin Arian Palluqi, përgjegjës Sektori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në Fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës.

Fjalën e ka relatorja dhe më pas përfaqësuesit e ministrisë.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti kryetar!

Dua të theksoj se projektligji synon të përafrojë pjesërisht dy rregullore të Komitetit European të viteve 2013 dhe 2014. Pa hyrë në detaje, meqenëse do ta kenë fjalën punonjësit e ministrisë të raportojnë, dua të them synimet kryesore të këtyre ndryshimeve, të cilat janë:

Së pari, disiplinohet aktivitetet e organizatave të peshkimit, me qëllim shmangien e peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar.

Së dyti, përcaktohen parimet mbi të cilat mbështetet dhe kushtet që duhet të plotësojë organizata e peshkimit për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së peshkimit të transferuar.

Së treti, përcaktohen e format, mënyrat dhe kriteret për menaxhimin e infrastrukturës portuale.

Së katërti, përcaktohen përgjegjësitë që duhet të ketë ky institucion përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës.

Së pesti, unifikohen disa terma, me qëllim saktësimin e tyre.

Çfarë më bëri mua përshtypje, sigurisht, duke mos e njohur shumë fushën, por në tërësi nga të gjitha ndryshimet që ministria sjell sot për t’i diskutuar në komision?

Së pari, nuk jam e qartë lidhur me domosdoshmërinë e rishikimit të ligjit. Cilat janë argumentet? Pse ju lindi kjo nevojë për ta rishikuar, ligjin të paktën në relacion.

Së dyti, impakti që do të ketë? Si do të ndikojnë realisht ndryshimet që ju sillni sot në rregullimin më të mirë të peshkimit, në garancinë, në cilësinë, në mbrojtjen e konsumatorit?

Së treti, në relacion shkruhet që, në zbatim të ligjit të vitit 2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ky projektligj i është nënshtruar procesit të njoftimit dhe konsultimit

publik nëpërmjet publikimit në regjistrin elektronik. Gjatë periudhës së pritjes së komenteve, sipas afatit të përcaktuar në ligj, nuk pati asnjë koment apo sugjerim, gjë që më çudit jashtë mase, sepse mendoj se ka grupe të ndryshme interesi, të cilat duhet të kishin reaguar. Për mua duhet të kishit qenë më proaktivë për t'i kontaktuar dhe përfshirë (më duket pak çuditshme). Pjesa tjetër është se, nga kontaktet që unë kam pasur këto dy ditë më kanë thënë se kanë dëshiruar dhe kanë sugjeruar herë pas here edhe ndryshime të tjera në këtë projektligj, përveç këtyre që kanë ardhur sot. Kështu që dua edhe këndvështrimin tuaj. Përveç kësaj, dua që pas seancës së sotme, t'i sugjeroja kryetarit dhe komisionit që të bëjmë një seancë dëgjimore ne si komision me grupet e interesit për t'i dëgjuar, për të marrë këndvështrimet e tyre, sugjerimet lidhur me këto ndryshime që paraqiten, mbase edhe ndryshime të tjera.

Çështja tjetër për të cilën dua më shumë informacion është edhe monitorimi i institucionit që ju sugjeroni të krijohet, varësia që për mua nuk është shumë e qartë, si do të monitorohet ky institucion dhe puna e tij në vazhdimësi. Ndoshta pas prezantimit tuaj, edhe unë do të jem pak më e qartë, sepse e thashë nuk e njoh mirë fushën, kështu që kam nevojë për më shumë informacion nga ju. Gjithsesi propozoj që të bëhet patjetër një seancë dëgjimore. Ne e kemi parashikuar në Konferencën e Kryetarëve në seancë plenare që të jetë në datën shtatë, nuk e di nëse do të arrijmë, por, pa diskutim sugjeroj një seancë dëgjimore me grupet e interesit duke përfshirë jo vetëm institucione dhe shoqata peshkatarësh, por edhe Universitetin Bujqësor, duke qenë se ka një departament, që ka një sektor të veçantë për peshkimin dhe akuakulturën.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zonja Gjermani!

Fjalën e kanë përfaqësuesit e ministrisë për të dhënë disa sqarime lidhur me projektligjin e propozuar dhe me çështjet që shtroi relatorja.

Roland Kristo – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, dua të them se ky është një ligj modern dhe bazohet në 5 rregullore të Komisionit Europian. Një nga këto rregullore, rregullorja nr. 104 e vitit 2000, e cila kishte të bënte me pjesën e organizimit dhe funksionimit të organizatave prodhuese, organizatave në peshkim është shfuqizuar nga rregullorja përkatëse e Bashkimit Europian, rregullorja nr. 1379. Ky ndryshim, që ne kemi sjellë, është reflektim i ndryshimit, i shfuqizimit të rregullores përkatëse të Bashkimit Europian me rregulloren e re nr. 1379 të vitit 2013. Pra, pjesa më madhe e ndryshimit këtu konsiston. Ka qenë neni 61 në ligjin nr. 64, i cili ka qenë një nen relativisht më i gjatë dhe ky nen është zvogëluar, duke kaluar më pas në shtimin e dy neneve të tjera, 61/1 dhe 62/2, të cilat janë në përputhje me ndryshimet që ka pësuar

legjislacioni i Bashkimit European. Ky është elementi i parë dhe besoj se i jep përgjigje edhe faktit pse është risjellë për ndryshime.

Gjithashtu, një pjesë e projektligjit ka të bëjë me peshkimin e vogël artizanal bregdetar.

Së pari, përtej unifikimit të termave, që është i parashikuar në ligj, ky unifikim është bërë në përputhje me përcaktimet e fundit që ka rregullorja përkatëse e Bashkimit European, e cila është cituar edhe në relacion, kjo ka të bëjë edhe me mënyrën se si ne do ta rregullojmë të gjithë aktivitetin e peshkimit të vogël artizanal. Fakti është se sot janë rreth 200 e ca varka të vogla në bregdet dhe kanë një nivel shumë të lartë informaliteti në peshkimin e vogël artizanal. Atë që ne parashikojmë me këtë ligj, është që t'u japim mundësi varkave të vogla të peshkimit artizanal të grupohen dhe mënyra e funksionimit të tyre të jetë mbi bazën e organizatave prodhuese ose organizatave të menaxhimit, pra formave të ndryshme të organizimit të njohur nga ligji. Kjo do të rrisë shkallën e formalizimit, do të rris shkallën e kontrollit të bregdetit dhe, në krahun tjetër e gjithë, kjo do të pasohet edhe me akte të tjera të politikave të ministrisë, të cilat do të shkojnë, krahas pjesës së rritjes presionit për normalizim, dhe me politika mbështetëse që ky formalizim të jetë i shoqëruar me politika favorizuese.

Me kalimin e ligjit ne do të shikojmë përfshirjen edhe në kuadrin e skemave mbështetëse të AZHBR-së për krijimin ose ndërtimin e qendrave të vogla gjatë bregdetit të grumbullimit të peshkut, të cilat më pas do të ofrojnë një standard më të lartë për sa i përket sigurisë ushqimore sikurse një raportim më të drejtë të zënieve dhe të gjithë pjesës së formalizimit të sektorit.

Në lidhje me institucionin, besoj se i drejtoreshit çështjes së institucionit që parashikohet në ligj, nuk është një institucion i ri. Aktualisht ne në ligj e kemi: Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, pra është një institucion drejtoria, i vetmi ndryshim është ai emërtimit nga drejtori në mendojmë që ta kalojmë në agjenci. Pra, në fazat e diskutimit që kemi bërë me Ministrinë e Financave gjatë procesit të diskutimit të ligjit, ata sugjeruan që të mos kalojë direkt në emrin agjenci, por të thuhet institucioni përgjegjës, pasi është më e saktë nga ana ligjore, duke qenë se mund të ndryshojë me kalimin e kohës dhe më pas të mos ketë ndryshim emërtimi. Fakti është që DSHPA-ja sot është një drejtori jashtë ministrisë, në varësi të ministrisë dhe që është përfaqësuesja e të gjithë pjesës së shërbimeve që ofron ministria ndaj sektorit të peshkimit. Pra, nuk krijohet një institucion i ri, por vetëm kemi një riemërtim të tij.

Në lidhje me çështjen e konsultimit publik, përveç asaj që është shkruar në relacion, duhet të keni parasysh një gjë: në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas ligjit “Për peshkimin” ekziston komisioni konsultativ që qendror për peshkimin dhe akuakulturën. Ky komision, i cili drejtohet nga ministri, në muajin mars ka shqyrtuar ndryshimet e këtij projektligji. Komisioni konsultativ, përveç një pjese të administratës së ministrisë, përbëhet edhe nga përfaqësuesit e grupeve të interesit. Çështjet që kishin të bënin me pjesën e rregullimit të aktivitetit të peshkimit, sidomos për peshkimin e vogël bregdetar janë reflektuar në këtë projektligj, sidomos ndarjet e përgjegjësi midis administratës dhe grupeve të interesit.

Nuk e di nëse iu përgjigja pyetjeve? A keni diçka tjetër?

Faleminderit!

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera?

Edmond Panariti – Të pranishmit janë këtu për të na dhënë shpjegime në lidhje me ndryshimet në projektligj, në kuadrin e disa shtesave në ligjin ekzistues “Për peshkimin”. Sigurisht, edhe në ligj duhen reflektuar ato që ndodhin në nivelin e Bashkimit Europian në ndryshimin, shfuqizimin futjen në fuqi të direktivave dhe rregulloreve të reja.

Kam disa pyetje specifike.

Së pari, dua të përqendrohem te pika 83 e projektligjit, ku propozohet të futet pika 83/1 “Për sistemin e monitorimit të anijes”.

Pyetja ime është: ky sistem i identifikimit të anijeve të peshkimit, përcaktimit të pozicionit të anijeve të peshkimit, të *databazës* përkatëse për sa i përket peshkimit është zgjatim i sistemit blu boks, që ka qenë ekzistues dhe që ka qenë një investim i Bashkimit Europian, apo bëhet fjalë për diçka të re?

A ka qenë e rregulluar deri tani, pse kërkohet të rirregullohet? E bëj këtë pyetje, sepse kjo për mua është “thembra e Akilit” e sistemit të peshkimit që përfshin çështjen e asaj që përmendi edhe relatorja, e kontrollimit të peshkimit ilegal, pse jo edhe të kontrollit të trafikeve, se anijet e peshkimit nuk janë përdorur vetëm për peshkim, janë përdorur edhe për aktivitete të tjera. Prandaj çështja e identifikimit të pozicionit të tyre është një çështje shumë serioze që ka të bëjë edhe me sigurinë kombëtare, nuk ka të bëjë vetëm me aktivitetin peshkimit.

Unë dhe Niko kemi qenë ministra, por edhe ju e dini që ky sistem ka ceduar rëndë. Praktikisht ka pasur ndërprerje të gjata të sistemit të sinjalit identifikues. Pa llogaritur faktin se, edhe kur ka funksionuar, ka funksionuar në mënyrë gjysmake. Pra, anijet nuk kanë raportuar. Ne kemi pasur shkallën më të rëndë të raportimit të mangët nga sistemi i anijeve të

peshkimit. Pra, ky ka qenë një defekt i rëndë dhe i shtrirë. Kjo ka bërë që statistikën e peshkimit kanë qenë statistika jo të vërteta, pra nuk kanë reflektuar atë që realisht ka ndodhur në sektorin e peshkimit. Praktikisht, në qoftë se kemi një flotë peshkimi nr. 280, raportimi është bërë për 2-3, pikërisht, sepse operatorët nuk e di ku ka qenë përgjegjësia, ka qenë përgjegjësia tek ai që e ka menaxhuar sistemin blu boks-ve... E di që ka qenë një sherr i paparë midis atyre që menaxhonin flotën e peshkimit, të cilët thoshin: “jo u prish pajisja, jo nuk na vinte sinjali”. Realisht të dhënat mbi speciet e peshkuara, mbi sasinë e peshkuar dhe mbi thellësinë e peshkimit, sepse edhe kjo ka rëndësi, se mund të bësh batërdi në cekëtinë, në qoftë se këto nuk dokumentohen në sistemin e databazës. Prandaj, këtu dua një specifikim të saktë. A është vazhdimësi e sistemit aktual të identifikimit, regjistrimit dhe raportimit? Shqipëria ka nënshkruar edhe *triple agreement*, kini parasysh një dokument shumë i rëndësishëm, ku angazhohet të kontrollojë peshkimin e paautorizuar, peshkimin ilegal dhe *under raportin*. Pra, është një detyrim kontraktual ndërkombëtar.

Së dyti, shikoj që pika 1 e nenit 44, ndryshohet si më poshtë: “Mjetet që përdoren për peshkim shpëlodhës, argëtues, mënyra lëshimit të autorizimit përcaktohen me udhëzim ministri”. Pse me udhëzim të ministrit? Këtu bëhet fjalë edhe për biznes, nuk bëhet fjalë për argëtim. Ky është biznes i mirëfilltë, i cili praktikisht, në vendet e Bashkimit Europian tashmë, po konsiderohet një hobi. Praktikisht këta operatorë ngarkojnë me fatura për të paguar të gjithë ata që në një hapësirë të caktuar ushtrojnë edhe peshkim zbavitës. Nuk është zbavitës, është aktivitet i fuqishëm, me përfitime financiare. Turistët nuk vijnë vetëm për të shijuar, por vijnë edhe për aktivitete racionale. Prandaj, dua të di pse i është lënë ministrit kjo punë dhe pse nuk rregullohet me akte normative?

Gjithashtu, kam një paqartësi midis terminologjive, që synohen të unifikohen e drejta e peshkimit me licencën e peshkimit. Nuk janë e njëjta gjë, zotërinj, sepse më duket sikur presupozohet që thoni se e drejta e peshkimit është një term juridik dhe licenca e peshkimit, po kështu është një term juridik. Por e drejta e peshkimit në këndvështrimin tim nuk është individuale, ka të bëjë me një territor, ka të bëjë me një sipërfaqe, kurse licenca është individuale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Leja është individuale. Pra, leja presupozon të drejtën e drejta nuk presupozon lejen. Pra, duhet shumë kujdes në këtë histori, sepse mund të shkojmë në krijimin e situatave në monopol. Megjithatë, në këtë mes dua edhe mendimin e një juristi që mes të na sqaronte, sepse me këto dy terma shpeshherë mund të krijohen situata përjashtimore, e ka marrë të drejtën e të tjera. Pra, edhe kjo duhet sqaruar për të mos pasur paqartësi.

Përgjithësisht, ashtu siç e thashë, i qëndroj asaj se ligji aktual do të kërkojë ndërhyrje, amendime, sepse e tillë është dinamika në Bashkimin European dhe ne në njëfarë mënyre do të na duhet të rikthehemi shumë shpejt, sepse jemi në një proces përafrimi, por ato që t'i vendosim, t'i vendosim sa më mirë, sa më saktë dhe paqartësia, në mënyrë që të ketë qëndrueshmëri.

Niko Peleshi – Bëjmë një herë të gjitha pyetjet dhe më pas përfaqësuesit e ministrisë të bëjnë sqarimet.

Urdhëroni, zonja Gjermani!

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, unë nuk hyra fare te pjesa e neneve, duke qenë se do t'i kemi në një diskutim tjetër dhe nuk hyra në hollësi. Me këshilltarët e komisionit kemi parë dhe jemi rakorduar që duhen bërë disa ndryshime dhe duhen parë me detaje, pasi të diskutohen me ju. Por sot po e diskutojmë vetëm parimisht. Ndërkohë që lidhur me faktin nëse përputhen me direktivat e Bashkimit të European. Ky projektligj i kalon edhe Komisionit të Integritetit, që ka parë dhe ka sjellë sugjerimet dhe raportin, të cilat pa diskutim do të përfshihen dhe do të merren konsideratë nga ne kur t'i diskutojmë nën për nen.

Pyetja ime është: thuhet se projektligji synon të përafrojë pjesërisht me dy rregullore të Bashkimit European. Pse nuk e bëjmë plotësisht me rregullore të Bashkimit European, por pjesërisht? Dua një shpjegim, sepse në qoftë se vërtet jemi në këtë proces, hajde t'i bëjmë gjërat njëherë e mirë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni!

Dritan Bici – Dua të di, a ka ndonjë specie ose produkt peshkimi të territorit tonë që nuk pranohet nga Komuniteti European, si për shembull, historia e midhjes, që ka qenë e infektuar e të tjerë, a ekziston më kjo histori për speciet tona detare?

Pyetja tjetër lidhet me zbatimin e legjislacionit të vendit tonë krahasuar me vendet e Mesdheut, sepse edhe ato janë vende të Bashkimit European. Ku qëndron ndryshimi i legjislacionit të vendit tonë?

Ndoshta nuk është problemi juaj, por para disa vitesh vunë një moratorium për gjahun dhe sot e kësaj dite vazhdon, kështu që edhe peshkimi nuk duhet të përfshijë vetëm peshkimin në dete, por edhe në liqene. Në kohën e periudhës së shtimit të peshkut bëhet nami me gjueti skandaloze, me metoda të ndryshme, siç është metoda me eksploziv, kjo nuk është puna juaj, por është e shtetit që të mos lejojë këtë lloj gjuetie. Dua të di nëse ka studime që kjo veprimtari të shtrihet edhe në basenet e brendshme. Ndoshta mund të ketë rregulla të

caktuara për liqenin e Ohrit dhe të Shkodrës, por ka edhe liqene të tjera që janë krijuar në Shqipëri si rezultat i hidroenergjetikës, të cilat kërkojnë mbrojtjen e tyre. Marr shkak nga liqeni i Banjës, i krijuar në Gramsh, që është një rezervë e madhe peshkimi, ku ka filluar të gjuhët në mënyrë të parregullt, por që krijon të ardhura.

Niko Peleshi –Zoti Baraj, fjala për ju.

Besnik Baraj – Unë kam një rezervë për këtë ligj, sepse këtu del që organizatat prodhuese marrin kompetenca dhe attribute të organizatave menaxhuese, por, në fakt, këto janë në konflikt interesi, njëra është e interesuar që të ruajë peshkimin cilësor, mjedisin dhe të ketë një zhvillim të qëndrueshëm, ndërsa tjetra ka tendencën të ketë sa më shumë peshkim, pa pyetur për rezervat, speciet në rrezik, apo kriteret që direktivat e Bashkimit European i kanë parasysh.

Së dyti, Komisioni European dhe organizatat ndërkombëtare të peshkimit i japin përparësi peshkimit artizanal, meqenëse është miqësor me mjedisin, është cilësor nga pikëpamja e peshqve që zënë dhe që konsumohet 100% në treg, por, nga pikëpamja sociale, ata janë në kushtet e mbijetesës dhe kanë shumë probleme dhe vështirësi, ndërkohë që peshkimi masiv apo industrial është ai që dëmton basenat dhe këtë ekosistem. Dua të më jepni një shembull nga direktiva e Bashkimit European, ku në formë eksplicite thuhet se kur peshkatari merr licencën, detyrimisht duhet të futet në këto organizime. Sipas meje, ky kusht vihet për të penguar peshkimin artizanal.

Së treti, a ka rrezik që nëpërmjet këtij ligji detyrat e Autoritetit të Peshkimit t'u kalojnë shoqatave prodhuese? Cila është detyra e Autoritetit të Peshkimit dhe a atribuohen me ligj kompetencat që kanë të bëjnë me planet e zhvillimit, me monitorimin, me penalizimin e të tjerë? Duhet të ketë një institucion të pavarur që të ketë këto attribute, pastaj është diçka tjetër që ne kemi dobësi institucionale dhe nuk arrijmë dot me burimet njerëzore dhe teknikat e tjera, ato që tha zoti Panariti. Mua më duket e pavend në relacion shprehja: “Gjatë periudhës së pritjes së komenteve sipas afatit të përcaktuar në ligj nuk pati asnjë koment apo sugjerim”. Unë ju siguroj se nëse ne si komision do të kontaktojmë me grupe interesi, absolutisht do të ketë menjëherë ndjeshmëri të mjaftueshme për të ardhur këtu dhe për të sjellë rezervat e tyre të arsyeshme ose të paarsyeshme, por mendoj se kjo është një heqje përgjegjësie nga ana e institucionit kur mjaftohet me këtë.

Duke iu bashkuar edhe shqetësimit të zonjës Gjermani, unë sugjeroj që ne të bëjmë dy dëgjesa: një dëgjese me grupet e interesit, veçanërisht me ato të peshkimit artizanal, sepse vihet kusht për këtë grup që të aderojë në këto shoqata dhe nuk vihet për ato të mëdhatë, që janë dëmtuesit kryesorë dhe dëgjesën e dytë unë sugjeroj ta bëjmë me stafin profesional,

akademik, që është një mundësi për ura komunikimi me këtë staf, që realisht ofron ekspertizë, por, njëkohësisht, kjo ekspertizë duhet të harmonizohet dhe të difuzojë sa më shumë në politika qeverisëse dhe njëkohësisht ligjvënëse.

Faleminderit!

Niko Peleshi –Zoti Beqaj, fjala për ju.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Nëse marrim prodhimin e një viti të caktuar, dua të di peshën specifike që zë peshkimi i peshkut të egër, i kultivimit dhe agropërpunimit në peshkim. Dua të di peshën që zënë këto 3 nëngrupe dhe sa ka qenë eksporti dhe importi? Nëse është e mundur, dua që të ma jepni të ndarë në përqindjen se sa është produkti i papërpunuar dhe sa është produkti që vjen dhe përpunohet? Në qoftë se nuk i keni sot të dhënat, mund të na i sillni edhe gjatë ditëve në vijim, por më duhet të krijoj një ide për sektorin dhe jo për një nen të caktuar.

Faleminderit!

Robert Bitri – Sa shoqata kemi ne dhe sa njerëz kemi që bëjnë peshkim me anije të vogla, atë që quajmë peshkim artizanal?

Niko Peleshi – Fjalën e ka përfaqësuesi i ministrisë.

Arian Palluqi– Po filloj me pyetjet e zotit Panariti, meqenëse ka qenë edhe ministri im. Ditën që kam filluar punë, kam ngritur dy çështje: atë të sistemit të monitorimit të anijeve, që gabimisht quhet *bluboks*, por që për efekt të aparatit quhet i tillë, si dhe statistikat në peshkim. Unë i kam thënë ministrit që ato nuk janë të sakta.

Për sa i përket përkufizimit, sistemi i monitorimit të anijeve është ngritur me një fond të Komunitetit Europian në kuadër të projektit IPA në vitet 2010-2012, ishte detyrim, madje është edhe sot, jo vetëm në legjislacionin tonë, i cili ka adoptuar pjesën e monitorimit, kontrollit, vëzhgimit të peshkimit detar për vendosjen e këtij sistemi në sektorin e peshkimit. Ai ishte grant, ashtu siç janë të gjitha projektet IPA, jo vetëm për pajisjen dhe sistemin, por grant për pagesën e sinjalit për vitin e parë. Në vitin e parë sistemi ka funksionuar shumë mirë, përveç një rasti të veçantë kur është ndërprerë energjia elektrike në QNOD, por ditën që Komuniteti Europian, që ishte financuesi, u largua nga ky projekt dhe iu dorëzua palës shqiptare, nuk kam afeksion për të huajt, dhe na ngeli neve ta bëjmë këtë detyrë, fillimisht Ministria e Mjedisit, ku deri në vitin 2013 Drejtoria e Peshkimit ishte atje dhe më pas Ministria e Bujqësisë, e cila trashëgoi këtë sektor me problematikën që kishte nga Ministria e Mjedisit, patëm një qasje dhe kuptim të gabuar të komplet sistemit dhe paratë që buxheti i shtetit duhet t'i jepte për të mbajtur serverin dhe softin, që në fakt e kishte bërë një i huaj, sepse ajo është punë intelektuale, ne, si shqiptarë, vendosëm që këtë ta bëjë një kompani

shqiptare dhe kompania shqiptare pasi merrte lekët nga shteti, në vend që të mbante mirëmbajtjen e softit dhe serverit, bënte vetëm pagesën e sinjalit satelitor të anijeve, i cili ishte një detyrim ligjor i Komunitetit të Peshkimit, ku çdo pronar barke duhet ta paguajë vetë. Peshkatarët u mësuan keq me këtë gjë, nuk mund të mirëmbaheshin më nga kompania shqiptare, por paguhej sinjali dhe degjeneruan në këtë situatë ku jemi sot apo në mars të vitit 2017, kur mbaroi kontrata me kompaninë dhe çdo gjë u bllokua. Në të gjithë procedurën e ndjekur që nga viti 2013-2017 është gjetur shkelje nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe, për më tepër, Komuniteti i Peshkimit është penalizuar për të gjithë ata para që janë paguar për të mbajtur sinjalin me fonde të buxhetit të shtetit që paguhet nga peshkatarët, domethënë ka efekt prapaveprues.

Në diskutime të ndryshme që kemi pasur me Ministrinë e Financave dhe me Ministrinë e Mjedisin të gjithë insistonin dhe nuk e kishin të qartë se çfarë do të thotë sistemi, ku fillon detyrimi shtetëror dhe ku fillon detyrimi i privatit. Saktësimi që bëhet në këtë projektligj nuk ndryshon sistemin, nuk është gjë e re, por është thjesht për të ndarë kush është përgjegjës për çfarë, kush paguan për çfarë, kush e mban sistemin dhe kush paguan sinjalin.

Për sa i përket raportimit të të dhënave, sistemi i ngritur deri sot ka një kosto tjetër transmetimi elektronik i të dhënave, por me sistemin që do të ringrihet dhe që kemi përgatitur termat e referencës përfshihet edhe ERS-ja, e cila do të dalë me vendim qeverie se kur do të jetë e aplikueshme. Detyrimin që ka peshkatari sot për ta bërë me letra kur vjen në port dhe dorëzon peshkun duhet ta bëjë që në det me raportimin elektronik, të cilën ia mundëson kjo pajisje. Kështu që pjesa e raportimit që ka qenë *undervaluation*, zoti Mondë, që kemi qenë të dy në një mendje dhe i rregulluam shifrat edhe në raport me INSTAT-in, edhe me organizmat ndërkombëtare, vinte nga mosfunksionimi i sistemit të grumbullimit të të dhënave në nivel inspektori, siç ne e kishim.

Nuk ka asnjë ndryshim, është i njëjti sistem dhe është marrë konsulenca e huaj për të bërë specifikimet teknike për të shmangur çdo gjë. FAO ka një eksperiencë shumë të mirë, në kuptimin e organizatës së Kombeve të Bashkuara, e cila nuk ka asnjë konflikt interesi me grupe të veçanta nga njëra anë dhe nga ana tjetër do të ngrejë një qendër rajonale, ku të dhënat nuk do të shkojnë vetën në QNOD-në tonë, por edhe atje.

Problem ishin fondet, të cilat ishin planifikuar me AZHBR-në për një arsye apo për një tjetër.

Meqenëse zoti Kristo ka punuar disa vjet në universitet, ndoshta këtu ka konflikt interesi dhe për këtë më është bërë vërejtje edhe herën e kaluar kur kemi diskutuar për ligjin e akuakulturës, por unë dua të them, kam respekt për Universitetin Bujqësor, sepse kam

mbaruar edhe unë studimet atje, që sot në të gjithë atë katedër nuk ka një individ që të ketë punuar një ditë në peshkim dhe akuakulturë. Ata mund të kenë tituj “Profesor” dhe “Doktor”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk kam përjashtuar njeri dhe gjithmonë janë thirrur...

Niko Peleshi – Arian, vazhdo me përgjigjet e pyetjeve, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aria Palluqi – Zonja Gjermani, ky është një realitet dhe është lehtësisht i verifikueshëm.

Niko Peleshi – Arian, vazhdo me pyetjet, sepse është në vlerësimin e komisionit se kë duhet të takojë.

Arian Palluqi – Para se t’i jap fjalën zotit Kristo, dua t’ju them se, nëse ka sektor peshkimi sot që është jashtë organizmit, jashtë kontrollit, jashtë kushteve higjienosanitare dhe jashtë çdo lloj parametri, është peshkimi i vogël bregdetar, duke filluar nga gryka e Bunës në Kepin e Stillos. Ne kemi sot peshkimin që gjuhet nga çdo njeri që ka shtëpinë para deti dhe kërkon të hyjë në det. Ky ligj kërkon t’i organizojë ato për të gjitha arsyet që u përmenden.

Sqarimi i fundit për sa i përket të drejtës dhe lejes së peshkimit, *fishing right* është në të gjithë botën dhe sot nuk ndahet. Për shembull, para shqiptarit nuk mund të gjuajë një italian, para atij që është nga Vlora nuk mund të vij një shkodran të peshkojë, para një peshkatori që e trashëgon zanatin nuk mund të shkojë dikush tjetër. Prandaj, edhe si term “Fishing right” në literaturën e jurisprudencës nuk është ende i qartë, prandaj shkon ai dhe vë flamurin dhe thotë që është toka ime dhe do të gjuaj unë peshk. Leja e peshkimit është ajo që ne pajisim personin që do të ushtrojë këtë aktivitet.

Duhet të kemi parasysh që të gjitha vendimet e qeverisë ne i kemi nxjerrë në përputhje me të gjitha rregulloret e BE-së dhe jemi të detyruar që të mos e përdorim dot peshkimin si një valvul sociale, kushdo që të vijë, mund të gjuajë, por është me një numër të mbyllur licencash, që kaq barka do të gjuajnë në peshkimin fundor, në peshkimin në rrethim dhe për të gjitha format e gjuetisë, kaq peshkatarë në liqenin e Ohrit dhe kaq në liqenin e Shkodrës. Nuk e caktoj unë se cilët janë peshkatarët, por organizata mbi kriteret që thamë, e cila përcakton 200 vetë në Ohër, 400 në Shkodër e me radhë.

Faleminderit!

Roland Kristo – Lidhur me udhëzimin e ministrit për peshkimin çlodhës dhe argëtues, në fakt, ligji bën vetëm një saktësim, në formë të ngjashme është edhe në ligjin aktual, por e vetmja shtesë është fjala “Procedurat”. Domethënë ajo që ne duam të

rregullojmë në këtë ligj është që peshkimin çlodhës dhe argëtues me mjete lundrues, i cili është një aktivitet që zhvillohet në të gjithë botën, të mund ta zhvillojmë edhe në Shqipëri. Sot ne nuk kemi të drejtë t'i japim dikujt licencën për të bërë peshkimin çlodhës dhe argëtues, sepse ata që vijnë për një periudhë 10-ditore, u duhet të presin 1 muaj sa të përgatisin lejen. Prandaj ajo që ne parashikojmë dhe që kemi kontaktuar edhe me AKSHI-n është që do të krijohet një faqe dhe cilido subjekt që do të aplikojë duhet të bëjë pagesën përkatëse, i cili automatikisht merr të drejtën për peshkimin çlodhës dhe argëtues për mjetet lundruese me kohëzgjatjen dhe detyrimet që përcakton ligji. Kjo është mënyra që përdoret në të gjitha vendet e BE-së. E njëjta logjikë që përdoret është e publikuar në Ministrinë e Bujqësisë kroate, ku aplikohet dhe vendosen vetëm të dhënat e mjetit të personit, mënyra e pagesës me kartë krediti dhe automatikisht të vjen leje. E gjitha kjo shmang burokracitë. Shtesa e vetme që do të bëjmë në ligj është fjala “procedurat” dhe e gjithë pjesa tjetër është ashtu siç është sot në ligjin aktual.

Në lidhje me të drejtën e peshkimit, pa përsëritur ato që tha zoti Palluqi, unë dua të them se ne kemi dy forma të peshkimit, lejen e peshkimit, që u jepet anijeve dhe lidhjen me të drejtën e peshkimit. Ligji aktual përcakton që e drejta e peshkimit në ujërat e brendshme bëhet nëpërmjet konkurrimit publik me përjashtimet e përcaktuara. Në det ka edhe forma të tjera të aktivitetit të peshkimit, të cilat nuk përfshihen, që janë forma të peshkimit pa mjete lundruese. Çfarë do të bëhet me to? Si rregullohen? Fatkeqësisht, deri tani është përdorur kjo mënyrë e konkurrimit publik edhe për forma të tjera të aktivitetit të peshkimit në det, duke pasur si bazë ligjore VKM-në për konkurrimin publik për ujërat e brendshme. Stavniket, bilancet dhe grumbullim i molusqeve në bregdet nga peshkatarë që e tërheqin me krahë janë aktivitete që nuk kanë mjete lundruese, pra nuk kalojnë nëpërmjet QKB-së, por nëpërmjet konkurrimit publik. Vetëm këtë parashikon ky ndryshim, pra të përfshijmë edhe ato kategori, të cilat në një mënyrë apo në një tjetër kanë mbetur pa u përfshirë në ligjin aktual.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, po flas për të drejtën e peshkimit.

Edmond Panariti – Meqenëse jemi këtu, zoti Zëvendësministër, kjo çështja e emërtesës...

Roland Kristo – Më falni, është neni 4 i projektligjit që shtohet në nenin 30, pas pikës 6, shtohet pika 7 me këtë përmbajtje: “E drejta e peshkimit për format e tjera të peshkimit në det pa përdorimin e mjeteve lundruese fitohet nëpërmjet konkurrimit publik”. Pra, flas stavniket, bilancet dhe ata që grumbullojnë molusqe që nuk përdorin mjete lundruese, por në momentin kur do të përdorin mjete lundruese kalojnë nëpërmjet QKB-së,

është e zgjidhur me legjislacionin për lejet dhe licencat. Deri para një viti e ca janë dhënë stavnike nga ministria, por stavniku është në det, nuk është në ujërat e brendshme. Ky ndryshim bën rregullimin që të përfshihet edhe kjo pjesë, pra të jetë 100% me bazë ligjore, në bazë të VKM-së nr. 712.

Edmond Panariti – Zoti Zëvendësministër, po i referohem nenit 64/: “Peshkim pa përdorimin e mjeteve lundruese janë të gjitha format e peshkimit për zënien apo grumbullimin e peshqve dhe të organizmave detare/ujore, të cilat kryen pa përdorimin e mjeteve lundruese.” Duhet thënë edhe kjo “përjashto dinamitin dhe peshkimin me elektrik”.

Roland Kristo – Më fal, ajo është pjesë e Kodit Penal. Nuk është lloj peshkimi.

Edmond Panariti – Ose të paktën të thuhet “përjashto ato forma që ndikojnë në dëmtimin e mjedisit”...

Roland Kristo – Ato forma, që janë të ndaluara me ligj ose nga Kodi Penal, nuk mund t’i përsëris.

Edmond Panariti – A jeni i sigurt se është në mënyrë eksplicite në Kodin Penal?

Roland Kristo – Për peshkimin me dinamit, helme dhe me energji elektrike në nenin 200 e ca i Kodit Penal...

Edmond Panariti – Nëse aty thuhet në mënyrë eksplicite se ndalohet peshkimi me mjete plasëse, me elektrik, me qysqi.

(Diskutime pa mikrofon)

Roland Kristo – Ato janë mjete të shfarosjes në masë.

(Diskutime pa mikrofon)

Edhe në pjesën e masave administrative e keni të shkruar.

Në lidhje me pyetjen pse nuk është e përputhur plotësisht rregullorja e BE-së, duhet të kemi parasysh se rregullorja nr. 1379 e Bashkimit European është një rregullore, e cila përveç pjesës së organizimit ka edhe një seri elementesh të tjera, të cilat ne kemi parashikuar t’i bëjmë me VKM. Këtu kemi të bëjmë me format e deklaratave, me mënyrën e organizimit dhe një seri formash të tjera, të cilat nuk mund të futen në ligj, sepse kalon pastaj shumë e detajuar. Ne kemi futur në ligj objektivat dhe fushat e përgjegjësisë së organizatave. Pjesa tjetër e kësaj rregulloreje do të miratohet me VKM ose me rregullore në ministri. Janë shumë gjëra teknike, të cilat nuk janë dhe nuk mund të jenë pjesë e ligjit të peshkimit.

Në lidhje me pyetjen nëse ka ndonjë rregullore të BE-së që e detyron peshkimin e vogël artizanal të organizohet, duhet të kemi parasysh se, në qoftë se ne shikojmë legjislacionin e Bashkimit European në fushën e peshkimit, ai është drejtuar vetëm ndaj peshkimit detar. Për sa i përket peshkimit në ujërat e brendshme dhe peshkimit të vogël

artizanal, kjo është kompetencë e secilit vend anëtar. Pra, nuk ka rregullore të BE-së, të cilat merren me peshkimin e vogël artizanal.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, modeli që ne kemi zgjedhur është modeli kroat dhe ai italian. Në këto dy shtete të Bashkimit Europian mënyra e organizimit bëhet nëpërmjet organizatave, konsorcumeve dhe formave të ngjashme. Natyrisht, ne kemi interes që peshkatarët e peshkimit artizanal të bashkohen. Ky është interesi ynë. Duke qenë bashkë, ne do të bëjmë edhe pjesën e politikave mbështetëse nëpërmjet AZHBR-së.

Në kuadër të një projekti të Koperacionit Italian kemi filluar censusin e të gjithë peshkimit të vogël artizanal që nga Buna deri në kepin e Stillos. Gjithashtu, do të përcaktojmë edhe zonat se ku ata janë më shumë të përqendruar. Unë e di që në bregdetin e Divjakës janë zyrtarisht 10 varka dhe 20 të tjera që mund të jenë pa leje. Po ku ankorojnë më shumë? Cila është pjesa ku mund të qëndrojnë më mirë këto barka? Pra, kjo do të bëhet nëpërmjet këtij censusi. Mbi bazën e kësaj ne do të përcaktojmë pastaj edhe zonat që mund të quhen qendra të grumbullimit ose qendra të prodhimeve të peshkimit, me qëllim që produkti që do të dalë t'i rritet cilësia, të jetë i trajtuar qoftë nga pikëpamja cilësore, qoftë edhe nga pikëpamja e sigurisë ushqimore.

Formalizimi nuk do të bëhet me dhunë, por nëpërmjet politikave mbështetëse. Bashkohuni, ndërtojmë qendrën, me qëllim që të arrijmë të gjithë një rezultat të përcaktuar.

Në lidhje me faktin se ku jemi në krahasim me legjislacionin e vendeve fqinje, duhet të kemi parasysh se Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun është një organizatë rajonale e menaxhimit të peshkimit. Ne momentin kur Shqipëria është anëtarësuar në këtë organizatë, me ligjin specifik ne kemi deleguar një sërë kompetencave tona menaxhuese te kjo organizatë. Kjo është normale për faktin e thjeshtë se resursi në det është i bashkëndarë midis nesh, Italisë, Kroacisë, Sllovenisë, Malit të Zi, Greqisë apo të gjitha vendeve të tjera të Mesdheut. Nuk mundet të bëjë dot Shqipëria politika jashtë politikave globale të Detit Mesdhe. Rregullat që vendosen në Komisionin e Përgjithshëm të Peshkimit të Mesdheut janë të detyrueshme për zbatim edhe në Shqipëri. Ky komision luan rolin e një kushinete midis BE-së dhe vendeve të tjera joanëtare të BE-së. Mesdheu është i madh, përbëhet jo vetëm nga vendet e Bashkimit Europian, por edhe nga vende të tjera të Afrikës së Veriut, natyrisht vendet e Europës që kanë mbetur jashtë janë Shqipëria dhe Mali i Zi. Bashkimi Europian duke qenë se është financuesi kryesor i Komisionit tenton që politikat e saj që i ka me rregullore, t'i detyrojë edhe vendet e tjera për t'i zbatuar, përpiqet të komandojë komisionin. Komisioni mban interesat e vendeve në zhvillim, ose të vendeve të tjera që nuk kanë aspiratat

për t'u anëtarësuar, dhe politikave shtresuese të BE-së. Këtë rol luan ky si komision. Ne si vend anëtar jemi të detyruar ose jemi gjithmonë në miratimin e rekomandimeve dhe rregulloreve që nxjerr Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit. I fundit është në lidhje me planin e menaxhimit të pelagjikve të vegjël, i cili u miratua vjet dhe jemi duke e ndjekur. Raportojmë në mënyrë periodike në lidhje me flotën, me zëniet dhe me masat që marrin, me sezonet, me periudhat e ndalimit, pra me të gjithë atë pjesë të problematikës që është lidhur me mënyrën e menaxhimit të peshkimit në Detin Mesdhe.

A ka studime edhe për pastrimin e ujërave të brendshme?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne ende nuk i transportojmë molusqet drejt tregut të BE-së. Para pak kohësh, kur zoti Peleshi ishte ministër, i ka dërguar një letër zyrtare komisionit, ku ka kërkuar që gjatë këtij viti të vijë auditimi, me qëllim që të shikojë mënyrën e hedhjes në treg dhe të trajtimit të të gjitha molusqeve në Shqipëri. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për midhjet e Butrintit, por për të gjitha molusqet e bregdetit, por edhe për zonat e tjera të prodhimit të midhjeve, si në Shëngjin apo në Gjirin e Lalzit, pra është një gamë më e gjerë. Ajo që ne kemi kërkuar ne si fazë e parë është që të paktën të arrijmë të çelim eksportin e molusqeve të përpunuara. Domethënë, të mos eksportohen të gjalla, duke qenë se kërkohen më shumë garanci nga BE-ja, por këto molusqe të përpunohen në industrinë tonë përpunuese dhe të shkojnë drejt BE-së të përpunuara, natyrisht duke shmangur edhe pjesën e rrezikut që vjen nga ngarkesa bakteriologjike. Pjesa tjetër e bitoksinave ose e metaleve të rënda apo të gjitha elementeve të tjera, janë pjesë e një pune rutinë të kësaj ministrie prej vitesh, është një çështje më e lehtë për t'u monitoruar dhe për t'u raportuar ndaj BE-së.

Pyetjen për basenet e brendshme nuk e kuptova shumë saktë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, ligji e ka parashikuar qoftë në mënyrë specifike, qoftë edhe në rregullat e përgjithshme, se nuk shikohet vetëm ligji, por shikohet e gjithë pjesa e rregulloreve, e VKM-ve.

Në lidhje me ujëmbledhësit e bujqësisë, ne kemi parashikuar në ligj një ndryshim që ministri në një fazë të dytë të shikojë mundësinë që edhe një pjesë të kompetencave për të dhënë të drejtën e peshkimit t'ia delegojë pushtetit vendor.

Kjo është një çështje që do të kërkojë diskutim të gjerë. Nuk është thjesht një çështje që kërkon ta mbajë ministria për një arsye apo për një tjetër, por është një çështje që, po të delegohen këto kompetenca, pushteti vendor duhet të japë garancitë që do të dijë ta menaxhojë. E mendojmë këtë, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

T'ia japë këtë të drejtë, edhe të monitorimit, edhe të raportimit të statistikave...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë thashë që është çështje diskutimi. Natyrisht, ka pro dhe kundër sa të doni, por është një çështje që do të kërkojë diskutim. Ka shumë faktorë pro, ka edhe shumë faktorë kundër. I pari: a është sot gati pushteti vendor për ta marrë atë? I dyti, a do ta përdorë pushteti vendor sa herë të ndërrohen kryetarët e bashkive, që i ndërrojnë lejet? Pra, ia ka dhënë X-it kryetari i parë, vjen tjetri do t'ia heqë. Natyrisht, të gjitha këto janë kosto. Mua nuk më intereson ky fakt, por fakti që nuk zhvillohet aktiviteti. Duhet të ketë një debat të hapur. Ne e shikojmë si mundësi, por nuk është një çështje që zgjidhet menjëherë.

Në lidhje me pyetjen nëse kanë konflikt interesi me organizatat prodhuese dhe me delegimin e kompetencave, po të flasim për organizatat prodhuese në BE do të kemi parasysh se sot e gjithë pjesa e legjislacionit për organizatat prodhuese në të gjitha fushat, në peshkim, bujqësi apo në sektorë të veçantë të frutikulturës apo në sektorë të tjerë është pjesa më e mbështetur me legjislacionin e BE-së qoftë nga ana e lehtësimit të të bërit biznes, qoftë edhe më mbështetje financiare. Unë do t'ju jap vetëm një shifër. Sot në BE prodhimi nga organizatat prodhuese është 15% e totalit të BE-së. Në qoftë se e marrim BE-në si një ekonomi të tërë, 15% e këtij prodhimi vjen nga organizatat prodhuese. Kjo vjen nëpërmjet një politike agresive, mbështetëse qoftë legjislative, qoftë edhe fiskale. Duket e thjeshtë ose mund të mendohet se ka një konflikt interesi, por duhet të kemi parasysh se organizatat prodhuese fillojnë që nga zënia e prodhimit deri te produkti final në treg dhe rregullojmë në mënyrën më të mirë kërkesën dhe ofertën. Sot, kur gjithsecili mund të peshkojë veç e veç, mund të ketë luhatje të çmimit ose prodhim që mund të hidhet. Nesër kur organizata të rregullojë tregun, detyrohet edhe prodhuesi se sa peshk duhet të kapë. Në fund të fundit, për pjesën e administratës së peshkimit, duke kufizuar sasinë e peshkut të kapur, shkohet në drejtim të mbrojtjes së resursit, prandaj mbështet fuqimisht nga legjislacioni i BE-së. Natyrisht, pjesa e rregullores nr. 1379 është për të shmangur efektet e moskonkurrencës, pra të krijimit të situatave monopol, për mënyrën se si janë raportet midis anëtarëve të organizatave prodhuese dhe një sërë faktorësh që ne do t'i kalojmë gradualisht me vendime të Këshillit të Ministrave në momentin kur organizatat prodhuese të krijohen, të fuqizohen ose të marrin vërtet statusin që kërkon ky ligj. Kjo është pjesa tjetër që nuk e futim dot në ligj tani, pra çfarë raporti do të ketë prodhuesi me organizatën, çfarë lloj formati do të jetë statuti, ose elemente të tjera që janë shumë teknike, të cilat do të miratohen në një fazë të dytë.

Ju thashë që kemi marrë eksperiencën kroate dhe italiane në lidhje me faktin që këto organizohen. Ne nuk ia delegojmë të gjitha kompetencat. Ne do të krijojmë të gjitha mundësitë që të kemi pjesën e bashkëpunimit me grupet e interesit. Është më mirë t'i kesh partnere grupet e interesit se sa t'i kemi në rolin "unë jam i pari dhe do të vij të të kontrolloj". Është më e thjeshtë për pjesën e menaxhimit, pra kur vetë peshkatarët janë të ndërgjegjësuar dhe të interesuar që mbrojtja e këtij resursi është për të ardhmen e tyre, atëherë i ke aleatë. Në qoftë se merren masa arbitrare dhe ai nuk e kupton, natyrisht që nesër do ta kesh kundër. Kjo është logjika. Ne nuk i delegojmë detyrimet tona, pra t'ua lëmë atyre ne dorë për t'i ruajtur. Ne nuk po e shkrijmë inspektoratin. Përkundrazi, ne do të vazhdojmë me të gjithë pjesën e forcimit, të garantimit dhe të arritjes së standardeve që na kërkohen nga Bashkimi European që Inspektorati i Peshkimit të jetë në nivelet, të cilat ne nuk i kemi. Për pjesën e bërjes aleat, duke i dhënë një pjesë të kompetencave, të përfshirjes së tyre në punën tonë, është pjesa më e mirë.

Në legjislacionin italian këtyre organizatave u njihet e drejta të marrin roje private me armë. Ne nuk e kemi një gjë të tillë dhe nuk mund ta futim. Këto organizata kanë atë që quhet "Guardia nave", që janë roje me armë. Ne nuk kemi inspektorët me armë dhe jo më të mendojmë të kenë privatët.

Në lidhje me të dhënat e prodhimit, të importit-eksport, që është pyetje e zotit Beqja, unë i kam të dhënat dhe po jua sjell këtu. Di që në vitin 2017 kundrejt vitit 2016 prodhimi ka qenë rritur me rreth 38%, për vitin 2018, tani që u mbyll, kundrejt një viti më parë, në volum është rreth 24,5%, ndërsa në vlerë është 10%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në 10%, por kini parasysh ndryshimin e kursit të euros. Por industria jonë përpunuese është një nga sektorët që po ecën me ritme të mëdha.

Ajo që është karakteristikë...

Ilir Beqaj – Më falni që ju ndërpres!

Jam i interesuar më shumë që nga vlera të kuptoj peshën që zë në nëngrupe, jo edhe aq vlerën në vetvete.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Roland Kristo – I kam tabelat dhe mund t'jua dërgoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, mor jo, import/eksportet, 16, 17.

Niko Peleshi – Bëjeni informacion zyrtar dhe na e dërgoni.

Roland Kristo – Dakord.

E rëndësishme është që po kalohet gradualisht, ose pjesa e përpunimit të prodhimeve vendase e ka rritur ndjeshëm peshën e saj.

Këtu janë dy elementet kryesore, me të cilët ne merremi sot me eksportin: *acciughe* dhe karkaleci, ku e para, falë edhe mbështetjes që u dha gjatë vitit të kaluar, në kuadër të AZHBR-së, është peshkuar për herë të parë në sasi shumë të mëdha. Një pjesë e këtij peshku sot është eksportuar, një pjesë është ende në fazën përgatitore, pasi kërkon një periudhë maturimi prej rreth 6 muajsh, por gjatë këtij viti do të eksportohet.

Gjithashtu, fushë e dytë e eksportit është karkaleci i thellësisë, i cili, edhe nga studimet e bëra sot në kuadër të Mesdheut, të GFSM-it, rezulton se është një specie e qëndrueshme, pra nuk është në rrezik mbipeshkimi.

Shqipëria gjendet në zonën e Adriatikut dhe, fatmirësisht, është një vend ku peshkohet më shumë sesa Italia apo vendet e tjera. E gjithë kjo sasi karkaleci shkon për eksport, kryesisht për tregun spanjoll, që është tregu kryesor.

Lidhur me pyetjen: sa shoqata kemi...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në Shqipëri, në vitin 2002 pati një projekt të Bankës Botërore, i cili nxiti të gjithë pjesën e organizimit të sektorit në shoqata, duke krijuar kështu organizatat e menaxhimit të peshkimit. Këto organizata, të cilat kanë thjesht emërtimin kështu, pasi, në fund të fundit, janë kooperativa shërbimesh, u krijuan qoftë në liqene, qoftë në det apo qoftë edhe në pjesë të caktuara të Shqipërisë, si Belshi, Shijaku, Ulza, pra në zona të caktuara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një pjesë e këtyre shoqatave kanë qëndruar ose janë forcuar gradualisht, ndërkohë një pjesë tjetër është shuar, si Belshi, Shijaku e zona të tjera.

Ne, si ministri, për një pjesë, me ato që kanë vazhduar dhe vazhdojnë, kemi kontakte dhe politika të vazhdueshme. Gjatë vitit të kaluar kaluam edhe një vendim të Këshillit të Ministrave, që e shpalli liqenin e Ulzës zonë bashkëmenaxhimi. Kjo eksperiencë, pra e bashkëmenaxhimit të të dyja palëve, ndërmjet nesh dhe organizatës, shtrihet për liqenin e Ulzës.

Të njëjtën praktikë kemi për Shkodrën, për Pogradecin, për Prespën, diku më mirë, diku më pak, por sidoqoftë kjo është pjesa e organizimit, në të cilën nga njëri krah kemi vetë organizatat, që janë të interesuara për mbrojtjen e resursit, ndërsa në krahun tjetër edhe

inspektorati bën detyrën e tij së bashku me agjencitë ligjzbatuese të shtetit shqiptar, duke bashkëpunuar me Policinë Kufitare ose me forcat e tjera që merren me këtë punë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, Landi!

Ka një koment nga zoti Baraj dhe pastaj nga të tjerët.

Besnik Baraj – Faleminderit!

Nuk mund të lë pa komentuar opinionin e zotit drejtor këtu në lidhje me nevojën e konsultimit me ekspertët në universitete të ndryshme në këtë fushë.

Është e vërtetë që ata mund të mos u japin rremave, nuk dinë si vozitet, nuk kanë prekur ndonjëherë rrjetë peshkimi, por të jeni i sigurt se ata që janë marrë me studime në atë fushë mund të jenë ekspertë më të mirë se ata në ministri.

Do të sjell fakte këtu, duke qenë edhe jashtë konfliktit të interesit, që me njerëz të tillë ne kemi bashkëpunuar dhe na kanë dhënë ndihmë jashtëzakonisht të dobishme për sektorë të ndryshëm, edhe pse nuk kanë punuar një ditë në atë sektor, sepse nisur edhe nga praktika e eksperiencave të marrjes së stafit akademik në shumicën e rasteve, është që studentët më të mirë caktohen në katedrat përkatëse dhe zhvillojnë studimet në atë fushë. Kjo lloj përvojë haset në të gjithë Europën, pavarësisht se nuk kanë punuar në sektorë peshkimi, të jeni i sigurt që konsultohen institucionet e Bashkimit European.

Për të kaluar në një fushë tjetër, kemi trajnerë me famë botërore, që nuk kanë luajtur një ditë futboll, por që janë trajnerët më të mirë në botë sot. Shqipëria ka prodhuar kryeministra që nuk kanë punuar asnjë ditë, por janë bërë kryeministra. Kështu që, më duket e pajustificuar kjo.

Gjithashtu, dua të komentoj pak...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të doja që, krahas të dhënave që kërkoi zoti Beqaj, të di jo sa është pesha e peshkimit artizanal, që, për mendimin tim, nga opinionet që shfaqin vetë ata, kushtëzimi për t'u futur në këto shoqata mund t'i penalizojë ata, në një kohë kur kushtet e tyre, mundësitë për mbijetesë janë jashtëzakonisht të varfra. Pra, do të doja të dija peshën ekonomike që kanë. A mos ekziston rreziku i kalimit në një fazë monopol e të tjerë? Pastaj kam një pyetje për kuriozitet. Meqenëse Bashkimi European na ka penalizuar në njëfarë mase lidhur me eksportin e midhjeve, a ka shanse të eksportohen në vende jo të Bashkimit European?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ka pyetje ose komente të tjera? Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit shumë për shpjegimet!

Jam dakord me atë që sapo tha zoti Baraj, përveç faktit se është detyrim ligjor edhe për ju, si ministri, edhe për ne, si parlament, konsultimi me të gjitha grupet e interesit, pra marrja në konsideratë e sugjerimeve të tyre.

Duke qenë se projektligji është parashikuar të jetë në seancën plenare të datës 7 shkurt dhe meqenëse ju jeni në Konferencën e Kryetarëve, sugjeroj të shtyhet afati dhe ne të kemi kohën e duhur për ta shqyrtuar dhe diskutuar, për të dëgjuar grupet e interesit dhe për ta diskutuar bashkë nen për nen. A është e mundur të shtyhet data 7 dhe të bëhet për javën e ardhshme? Në qoftë se nuk është e mundur, do të na duhet të punojmë në mënyrë intensive, të bëjmë edhe seanca dëgjimore dhe pastaj nen për nen, ku kemi disa sugjerime dhe komente.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eglantina Gjermani – Ta shtyjme dy javë, atëherë.

Ky është sugjerimi im, si relatore.

Niko Peleshi – Edhe “Shën Valentini” është një lloj peshkimi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eglantina Gjermani – Tani, në qoftë se ne nuk marrim pedagogë universiteti, se nuk kanë peshkuar ndonjëherë, ne si deputetë do të na duhet të japim mendime dhe sugjerime. As unë nuk kam shkruar ndonjëherë për peshk, m’u desh të lexoja, por, sigurisht, më duhen sugjerimet e grupeve të interesit para se ta kalojmë këtë.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Dakord.

Atëherë, nëse nuk ka pyetje ose komente të tjera, ju lutem, pa komentuar për sa u përket konsideratave të ndryshme të Arianit dhe të Besnikut për akademikët, direkt në përgjigje.

Arjan Palluqi – Më falni, mundem?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Gjermani, e para, në komisionin konsultativ qendror për peshkimin dhe akuakulturën, një nga anëtarët është zëvendësdekan i Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit dhe anëtar i Departamentit të Peshkimit dhe Akuakulturës, zoti Edmond Hala. Ai ka qenë pjesë e të gjithë procesit dhe e njeh pjesën e ligjit.

(Deputetja Gjermani ndërhyr pa mikrofon.)

E dyta, në lidhje me sugjerimin tuaj për ta shtyrë afatin, ju lutem, ne duam të vendosim sa më shpejt të merremi me sistemin *bluebox*.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vitin e kaluar, për arsye të ndryshme, tenderi për blerjen e aparaturave, që do të bënte AKSHI, dështoi. Shqipëria rrezikon të marrë penalitet nga Bashkimi European për shkak se sistemi nuk është ende funksional.

Sa të kalojë ky ndryshim në ligj, kalon urgjentisht një ndryshim në VKM-në nr. 407, çka i hap rrugë AKSHI-t për të ngritur sistemin. Çdo shtyrje e këtij sistemi do të shtynte edhe procedurat.

Ju lutem, pasi edhe data 7 për ne ishte shumë vonë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

U vonua e gjithë pjesa...

Më falni!

Ju them vetëm një gjë: projektligji ka qenë gati që në muajin maj, ndërkohë që deri në shtator ka qenë në pjesën e kalimit në komisionin konsultativ, konsultimin me grupet e interesit, lënien në periudhën e të gjithë kohës minimale me ligj, që duhet të rrijë e publikuar, e afishuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për atë punë jeni.

Niko Peleshi – Dakord.

Arian Palluqi – Në lidhje me pyetjet e zotit Baraj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arian Palluqi – U përgjigj zëvendësministri.

Niko Peleshi – Ishte koment.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi? Mos e merr fjalën me vullnetin tënd.

Tani, nuk diskutohet se qëndrojnë këto që tha zëvendësministri, edhe urgjenca për *bluebox*-in, por e drejta e komisionit është mbi të gjitha, edhe e parlamentit, edhe e deputetëve, si dhe detyrimi për të bërë dëgjuesat e nevojshme është i pashmangshëm.

Është e vërtetë ajo që tha zëvendësministri, se në Ministrinë e Bujqësisë, ndoshta ndryshe nga fusha të tjera apo sektorë të tjerë, për peshkimin është i ngritur dhe i konsoliduar komisioni konsultativ për peshkimin, ku, siç e tha zoti Kristo, pjesa më e madhe e anëtarëve, pavarësisht se drejtohet nga ministri, përfaqësojnë grupet e interesit: prodhuesit, organizatat e menaxhimit të peshkimit e të tjerë.

Megjithatë, unë propozoj që, pa ndryshuar datën 7, ne të synojmë t'i ezaurojmë të dyja, pra edhe diskutimin nën për nën, por, para se të shkojmë te diskutimi në parim dhe nën

për nen, të bëjmë dy dëgjesa. Dëgjesa e parë të jetë me kryetarët e organizatave të menaxhimit të peshkimit, pasi kooperimi në fushën e peshkimit në vend është një nga rastet e suksesshme në Shqipëri. Pra, këto kooperativa, që me ligj quhen “Organizatata e menaxhimit të peshkimit”, edhe për të mos u quajtur kooperativa për shkak të konotacionit të së kaluarës, funksionojnë. Ka dështimet e veta, por ka edhe raste brilante, siç është liqeni i Shkodrës. Organizata e menaxhimit të peshkimit në liqenin e Shkodrës ka kryetar, menaxher, seli, ka zyra, ka qendër grumbullimi, si dhe ka arritur sukses me shmangien apo çuarjen drejt zeros të informalitetit, të paktën të peshkimit me gjeneratorë, siç kemi edhe raste që nuk po funksionojnë siç duhet. Ama jam i bindur, tani flas edhe për shkak se kam punuar më shumë se një vit bashkë me Rolandin, se kjo është forma më e mirë.

Ka forma të tjera, me delegim të privatët, koncesione të tjera, siç e ka pala maqedonase për liqenin e Ohrit, por ne derisa e kemi provuar, e kemi testuar, kemi histori suksesi, nuk kemi pse të mos i qëndrojmë. Ndaj ky ligj, në fakt, i forcon këto edhe me subjektet e peshkimit artizanal, sepse i detyron të jenë pjesë e një organizate, e disiplinon peshkimin, si dhe forcon organizatat, ku pa dyshim u jep autoritet.

Sigurisht, ka çështje që duhen diskutuar. Për shembull, një nga pyetjet që ngriti zoti Baraj lidhej me planet e menaxhimit: nëse duhet t’i hartojnë vetë organizatat dhe t’i monitorojë ministria, apo duhet t’i hartojë ministria, si në rastin e planeve të menaxhimit të pyjeve e të tjerë? Por këto do t’i sqarojmë kur të diskutojmë nen për nen.

Po ndërtohet një infrastrukturë e mirë.

Për dijeninë tuaj, e tha pak zoti Kristo, për markatat ka filluar Shëngjini, i cili mbaron shumë shpejt; do të fillojë Vlora, Saranda, ndërkohë që besoj se edhe qasja për të krijuar pikat e grumbullimit për peshkimin e vogël do ta konsolidojë shpejt infrastrukturën e grumbullimit, për të pasur pastaj edhe statistika më të mira.

Është i vërtetë edhe shqetësimi i zotit Panariti, edhe pyetja e zotit Beqaj, që lidheshin me të dhënat. Duhet thënë që si në shumë fusha të tjera, për hir të së vërtetës, por edhe te peshkimi, nuk kemi të dhëna të besueshme dhe afër realitetit, por kjo po shkon drejt konsolidimit. Besoj se qasja dhe vizioni është i duhuri.

Pastaj kemi një çështje tjetër, që e kemi pasur shqetësim, por tani po e them nga kjo karrigia tjetër tani, inspektimin nuk e kemi ende 24/7, pra nuk e kemi 24 orë në ditë dhe në 7 ditë të javës, çka është handicap, pasi nuk ka kuptim të inspektosh gjatë tetë orëve, sepse peshkimi ndodh edhe jashtë orarit të punës. Pra, nuk është se peshkatarët na marrin leje kur peshkojnë apo nuk është se respektojnë orarin e punës. Edhe kjo gjë kërkon burime, por besoj se ministria do ta çojë drejt zgjidhjes.

Propozimi im është që ditën e hënë të tentojmë dy dëgjesa, një me kryetarët ose menaxherët e organizatave të menaxhimit të peshkimit në vend dhe fill pas tyre një dëgjese me përfaqësuesit nga universitetet, ose në qoftë ka ndonjë institut apo qendër tjetër kërkimore, në dijeninë time, jo, por ndoshta jam i painformuar. Pra, të ftojme disa ekspertë të peshkimit nga universiteti dhe institucionet e tjera.

(Deputeti Bitri ndërhyr pa mikrofon.)

Si mendon relatorja?

Eglantina Gjermeni – Unë mendoj që në një dëgjese mund të jenë të gjitha grupet e interesit, por e rëndësishme është t’u dërgohen këto ndryshime. Nuk e di nëse kanë pasur sugjerime ose komente të tjera për ndryshimet ligjore. Kam merakun se do të hapet një proces, prandaj kërkova një lloj shtyrjeje afati. Megjithatë, e kuptoj urgjencën dhe domosdoshmërinë, por pa diskutim, sipas këtij kalendari, i bie që pasi të zhvillojmë seancën dëgjimore të hënën, pastaj të martën ta diskutojmë dhe ta miratojmë nen për nen, në qoftë se synojmë të arrijmë të martën.

Patjetër, do të kërkojë goxha impenjim nga stafi dhe nga ministria për të qenë edhe të hapur për të përfshirë sugjerime, komente dhe ndryshime që ne i kemi këtu, por edhe ato që mund të kenë grupet e interesit.

Përderisa i ftojme, nuk i ftojme vetëm për...

(Deputeti Bitri ndërhyr pa mikrofon.)

Niko Peleshi – Urdhëroni!

Roland Kristo – Tani, unë nuk jam partizan i këtyre miratimeve me shpejtësi të ligjeve, sepse ndoshta na dalin edhe probleme. Unë mendoj që për të bërë një dëgjese, varet sa të interesuar janë ata dhe sa është i mundur lajmërimi që të jenë ata faktorë. Por them se ndryshimet e ligjit, ndoshta mund të ketë edhe propozime të tjera nga sektori i peshkimit, meqenëse ne po merremi me këtë gjë... Unë propozoj të bëjmë edhe takime në dy raste, qoftë në Durrës, qoftë në Vlorë, me operatorët që merren direkt me këtë punë, se ndoshta mund të dalin edhe probleme të tjera.

Ideja është se edhe unë nuk është se kam kohë të tepërt, por që ta bësh ligjin këtu dhe të mos dëgjosh ata që peshkojnë, për mua nuk është normale.

Ndoshta mund ta shtyjme edhe pak, por duhet të dëgjojmë direkt operatorët, ata që merren me problemin. Kryetarët e shoqatave ka raste që ndoshta nuk janë të azhurnuar aq mirë me problemet që ka peshkimi.

Përderisa del Kryeministri dhe zhvillon takim me peshkatarë në Durrës, në Vlorë e të tjera me radhë, ne si komision duhet të jemi disi më afër me problemet. T'i dëgjojmë më mirë, se ndoshta mund të ketë propozime të tjera për ndryshime të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Në qoftë se është e mundur, në qoftë se arrini të keni edhe të dhëna për numrin e njerëzve të punësuar në sektor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ato që mund të keni.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Tani, meqenëse bëhet fjalë për disa ndryshime, nuk them se nuk janë të rëndësishme, por janë shtesa, plotësime të ligjit, pra nuk po bëjmë ligj të ri. Unë jam që ne ta tentojmë me dëgjuesën e ditës së hënë. Dakord, bëjmë vetëm një dëgjuesë. Pra, edhe kryetarët e organizatave të menaxhimit të peshkimit, anëtarë le të vijnë në qoftë se janë të interesuar, si dhe ekspertë të fushës. Në qoftë se do të shohim, po ta matim me temperaturën nga diskutimi, se ka pyetje, ka paqartësi, ka nevojë për kohë, e konsiderojmë edhe shtyrjen.

Në qoftë se nga organizatat nuk do të ketë çështje që kërkojnë kohë, kërkojnë angazhim të stafit për t'u reflektuar, vazhdojmë me kalendarin siç e kemi.

Është e vërtetë, e ritheksoj, komisioni i peshkimit në shumicën e tij përbëhet nga përfaqësuesit e grupeve të interesit dhe është shumë aktiv, pra nuk është një gjë formale, por janë takime që zgjasin, diskutojnë kryetarët e organizatave të prodhimit dhe të peshkimit; është komision që funksionon realisht, është aktiv, mund të shkaktojë edhe dhimbje koke, nuk është nga ata që ngrenë dorën, se ata vijnë për të mbrojtur interesat e tyre.

Mendoj se të paktën nga ana e ministrisë është ezauruar në mënyrë shumë korrekte, pra nuk është parakaluar ndonjë grup interesi. Gjithsesi, në respekt të së drejtës sonë, ditën e hënë do të tentojmë të zhvillojmë këtë dëgjuesë dhe pastaj të shohim e bëjmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të jetë e dukshme, Tani.

Në qoftë se kryetarët do të ngrenë shqetësime, do të jenë të painformuar, do të kenë shqetësime që nuk i gjejnë dot të reflektuara në ligj, i japim kohë vetes për të shkuar edhe në terren.

Biem dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'ju njoftojmë për orarin, meqenëse dita e hënë është pak e ngarkuar edhe me mbledhje të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për të martën do të ecim sipas kalendarit.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA